

NEKROLOGJI



JOSIF KOLE

Leskovik, 17 tetor 1938 – Bremen, 21 tetor 2015

Para disa muajsh, më 21 tetor 2015, u nda nga jeta kolegu dhe miku ynë i shtrenjtë, studiuesi i përkushtuar dhe i shtruar i gjuhës shqipe, leksikologu dhe leksikografi i mirënjohur, pedagogu i lindur dhe i dashur i disa brezave studentësh, prof. as. Josif Kole.

Më 1963, pasi mbaroi me rezultate të larta Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, u emërua pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik Dyvjeçar “Aleksandër Xhuvani” në Tiranë, ku dha leksione për morfologji dhe sintaksë të gjuhës shqipe, si edhe për hyrje në gjuhësi.

Në shtator 1967 kalon si punonjës shkencor në Sektorin e leksikologjisë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ku u shqua për punën e tij shkencore cilësore sidomos në leksikografi si bashkautor i *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* (1980) dhe i *Fjalorit të shqipes së sotme* (1984).

Ka botuar mjaft punime, artikuj e studime si brenda vendit, sidomos në revistën *Studime filologjike*, ashtu edhe jashtë shtetit, në Austri e ish-Jugosllavi. Ndër këto botime vendin kryesor e zënë ato për çështje të leksikologjisë, sidomos të fjalëformimit: “Prirje të zhvillimit të leksikut të shqipes në dritën e *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*”, “Një vështrim mbi emrat e prejardhur në **-ore**”, “Rreth emrave të prejardhur në **-ore**”, “Disa çështje të fjalëformimit dhe trajtimi i tyre në shkollë”; për ndërkombëtarizmat në gjuhën tonë: “Mbi fjalët ndërkombëtare në shqipe”, “Disa mendime për fjalët ndërkombëtare dhe vendin e tyre midis huazimeve të tjera leksikore të shqipes” dhe veçanërisht për kategorinë leksikogramatikore të pjesëzave në krahasim me pjesë të tjera të pandryshueshme të

ligjëratës në gjuhën shqipe: “Pjesëzat si kategori leksiko-gramatikore në shqipen e sotme”, “Pjesëzat e shqipes së sotme dhe trajtimi i tyre në shkollë midis pjesëve të tjera të pandryshueshme të ligjëratës”.

Ka hartuar për *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* mbi 4000 fjalë nga shkronjat D, Dh, I, J, M, P, T, Th.

Ka ndihmuar për redaktimin e 216 fjalëve nga shkronjat G, D, Q, dhe e 238 fjalëve nga shkronja Dh.

Është hartues i shkronjave Dh, I, J, Th dhe redaktues i fjalëve të shkronjave Dh, G, Gj, I, J, N, R, Rr të *Fjalorit të shqipes së sotme*.

Ka mbajtur kumtesa në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, gjermanisht në Austri dhe shqip në Shkup.

Ka marrë pjesë në ekspedita leksikologjike në vise të ndryshme të Shqipërisë. Ka qenë dy herë në Kosovë në ekspedita leksikologjike.

Njohës i mirë i gjermanishtes dhe i rusishtes, të cilat i ka dhënë provim pasuniversitar, ka hartuar dhe botuar shkrime që lidhen me gjermanishten: “Mbi drejtshkrimin e fjalëve me prejardhje nga gjermanishtja dhe në emra të përveçëm gjermanë”, botuar edhe në frëngjisht; ka hartuar tekste në gjermanisht për shkolla speciale teknike, si edhe *Librin e gjuhës gjermane* në dy pjesë.

Në vitin 1980 ka mbrojtur disertacionin “Mbi disa drejtime të pasurisë të leksikut të shqipes së sotme në dritën e fjalëve të shkronjave Dh, Z, J, M, P, T, Th të *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*” dhe ka fituar gradën “Doktor i shkencave”.

Ka qenë anëtar i redaksisë së revistës *Studime filologjike* dhe redaksisë së botimeve të *Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*.

Ka qenë anëtar i Këshillit shkencor të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Për veprimtari shkencore i është dhënë Urdhri “Naim Frashëri” me këtë motivacion: “Për ndihmesën e dhënë në fushën e studimeve leksikologjike e leksikografike, për punë të palodhur e veprimtari të frytshme si bashkëpunëtor e redaktor i *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*”.

Figura e Josifit do të ishte e paplotë pa trajtuar karakterin e tij të fortë tejet njerëzor, ndershmërinë e skajshme, dashurinë dhe respektin për njerëzit, nderimin për punën e kolegëve dhe gazin e harenë që shpërndante rreth vetes, sidomos me kitarën e vet që nuk e zuri më me dorë pas vdekjes së vajzës së tij të madhe, Monikës.

Kolegu dhe miku ynë i paharruar dhe i paharrueshëm prehet në varrezat Huckelriede në Breme të Gjermanisë, në një varr familjar, së bashku me gruan Antigoni Milo dhe vajzën Monika Kole.

Remzi PËRNASKA